



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 198

Tiranë – E Martë, 30 Dhjetor 2014

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 161/2014 datë 4.12.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”..... 11059
Ligj nr. 162/2014 datë 4.12.2014	Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis..... 11060
Ligj nr. 163/2014 datë 4.12.2014	Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë..... 11069
Ligj nr. 164/2014 datë 4.12.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 11074
Ligj nr. 165/2014 datë 4.12.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas nr. Alb-0028 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për pjesëmarrjen në financimin e projektit të rindërtimit të rrugëve dytësore dhe lokale..... 11080
Ligj nr. 166/2014 datë 4.12.2014	Për ratifikimin e ndryshimit nr. 3 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme”..... 11081
Ligj nr. 167/2014 datë 4.12.2014	Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes Istisna'a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan..... 11083

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 906, datë 17.12.2014	Për shpërblimin dhe kompensimin e disa kategorive të veçanta për Festat e Fundvitit.....	11085
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Skënder Meçe.....	11086



**LIGJ**  
**Nr. 161/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË LIGJIN NR. 10 237, DATË 18.2.2010,  
“PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË  
PUNË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 38, shkronja “d”, e pikës 2, dhe pika 3 shfuqizohen.

**Neni 2**

Në nenin 39, pika 1, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) siguron trajnimin profesional dhe edukimin në vazhdim në fushën e sëmundjeve profesionale dhe të mjekësisë së punës;”

2. Shkronjat “dh”, “ë” dhe “f” shfuqizohen.

3. Shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) miraton organizimin dhe detyrat e shërbimit shëndetësor, si dhe standardet e mjekësisë së punës.”

4. Në shkronjën “gj” fjalët “licencon” dhe “certifikon” shfuqizohen.

**Neni 3**

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 40**

**Autoritetet shtetërore përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë**

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë janë inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës dhe inspektorati shtetëror që mbulon fushën e shëndetësisë.

2. Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës ka këto përgjegjësi:

a) kontrollojnë hartimin dhe zbatimin e dokumentit të vlerësimit dhe parandalimit të rreziqeve në punë;

b) kërkon nga institucionet shtetërore përgjegjëse dhe shërbimet e specializuara të licencuara kryerjen e matjeve dhe marrjen për analiza të kampioneve të materialeve, të lëndëve dhe substancave të rrezikshme, që përdoren gjatë procesit të punës. Në çdo rast, duhet që punëdhënësi apo përfaqësuesi i tij të jetë në dijeni për qëllimin e marrjes së kampioneve;

c) urdhëron ndalimin e veprimtarisë, riparimin e defekteve, që vërehen gjatë funksionimit të pajisjeve apo gjatë përdorimit të metodave të punës ose modifikimin e instalimeve brenda një afati kohor, në rastin kur konstatohet ekzistenca e një rreziku serioz dhe të menjëhershëm ose të një sëmundjeje profesionale, dhe njofton, nëse është e nevojshme, organet përkatëse të prokurorisë;

ç) heton ngjarje, në përputhje me kompetencat e tij, autorizon hetimin dhe konfirmon karakterin e aksidenteve;

d) bashkërendon punën, së bashku me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe, nëse është e nevojshme, edhe me institucionet e tjera të përfshira në proces, për sistemin e raportimit dhe të mbajtjes së procesverbaleve për aksidentet në punë;

dh) kryen inspektime të përbashkëta me institucionet e tjera të përfshira në proces, për raste të ngjarjeve;

e) bashkërendon punën me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për sistemin e raportimit të sëmundjeve profesionale dhe të sëmundjeve që lidhen me profesionin;

ë) analizon veprimtarinë e personave dhe të shërbimeve të specializuara, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 7, të këtij ligji;

f) i raporton ministrit përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë për realizimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi;

g) i propozon ministrit përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë ndryshime në legjislacionin e fushës së sigurisë dhe të shëndetit në punë.

3. Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e shëndetësisë ka këto përgjegjësi:



a) ushtron kontroll me strukturat e tij të specializuara për cilësinë e shërbimeve mjekësore që u jepen punëmarrësve në vendin e punës;

b) ushtron kontroll për gjendjen shëndetësore të punëmarrësve dhe zbatimin e normave, rregullave e të procedurave lidhur me kontrollin e faktorëve të riskut që ndikojnë në shëndetin e punëmarrësve;

c) realizon detyra të tjera, në përputhje me kompetencat në këtë fushë, të cilat rregullohen nga ligje të veçanta;

ç) kryen inspektime të përbashkëta me institucionet e tjera të përfshira në proces, për raste të ngjarjeve.”

Neni 4

Në nenin 43, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për shkelje të dispozitave të këtij ligji që prekin fushën e shëndetësisë, kur nuk përbëjnë vepër penale, vendosen sanksione, rast pas rasti, sipas legjislacionit shëndetësor në fuqi nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë.”

Neni 5

Në të gjithë përmbajtjen e ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, emërtimet “Inspektorati Shtetëror i Punës” dhe “Inspektorati Sanitar Shtetëror” zëvendësohen, përkatësisht, me emërtimet “Inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës” dhe “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8862, datë 26.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani**

## LIGJ

Nr. 162/2014

### PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS<sup>1</sup>

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritimit të çështjes së mbrojtjes së ajrit në politika të tjera, si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit, dhe për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për këtë qëllim.

Neni 2

**Objekti**

Objekti i këtij ligji është:

a) përcaktimi dhe vendosja e vlerave kufi, pragut të alarmit, pragut të informacionit dhe vlerave të synuara për disa lloje ndotësish në ajër, të listuar në aneksin I, bashkëlidhur këtij ligji;

b) përcaktimi dhe vendosja e objektivave për cilësinë e ajrit në mjedis që synojnë të shmangin, parandalojnë ose pakësojnë efektet e dëmshme në shëndetin publik dhe mjedisin në tërësi;

c) vlerësimi i cilësisë së ajrit në mjedis, në bazë të metodave dhe kriterëve europiane;

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2008/50/KE, datë 21 maj 2008, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër në Europë”. Numri Celex 32008L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 152 datë 11.6.2008.

Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2004/107/KE, datë 15 dhjetor 2004, “Për arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit”, e ndryshuar. Numri Celex 32004L0107, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 23, datë 26.1.2005, faqe 3-16.



ç) marrja e informacionit mbi cilësinë e ajrit në mjedis, duke synuar parandalimin e ndotjes së tij dhe pasojave që lidhen me të, monitorimin e tendencave afatgjata, si dhe përmirësimin e tij nëpërmjet masave kombëtare e ndërkombëtare;

d) bërja e mundshme për publikun e informacionit mbi cilësinë e ajrit në mjedis;

dh) ruajtja e cilësisë së ajrit në mjedis aty ku kjo është e mirë dhe përmirësimi i saj në raste të tjera, përmes kufizimit të shkarkimeve nga burime të lëvizshme ose jo;

e) promovimi i bashkëpunimit me vendet e tjera për pakësimin e ndotjes së ajrit.

### Neni 3

#### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ajër i mjedisit” është ajri i jashtëm në troposferë, që përjashton ajrin në vendet e punës, në mjediset e ndërmarrjes dhe/ose biznesit dhe çdo vend tjetër brenda tyre ku punonjësit hyjnë për shkak të punësimit të tyre e ku zbatohen dispozitat për shëndetin dhe sigurinë në punë e ku publiku nuk hyn rregullisht.

2. “Ndotës” është çdo substancë e pranishme në ajrin e mjedisit, që ka mundësi të ketë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin në tërësi.

3. “Nivel” është përqendrimi i një ndotësi në ajrin e mjedisit ose depozitimi i tij në sipërfaqe në një kohë të dhënë.

4. “Vlerësim” është çdo metodë e përdorur për matjen, llogaritjen, parashikimin ose çmuarjen e niveleve.

5. “Vlerë kufi” është niveli i caktuar që duhet arritur brenda një periudhe të caktuar dhe që kur është arritur nuk duhet kapërcyer, përtej të cilit përcaktohet dëmtues për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Vlera kufi përcaktohet në bazë të dijeve shkencore, me synim shmangien, parandalimin ose pakësimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut dhe/ose mbi mjedisin në tërësi.

6. “Kufiri i tolerancës” është vlera kufi e shprehur në përqindje, e cila mund të kapërcejë një vlerë të caktuar, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

7. “Plani i cilësisë së ajrit” është plani që përcakton masat dhe indikatorët e cilësisë së ajrit, që synojnë arritjen e vlerave kufi ose të vlerave të synuara.

8. “Vlera e synuar” është një nivel i caktuar që synon shmangien, parandalimin ose pakësimin e efekteve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin në tërësi, për t’u arritur për një periudhë të caktuar kudo që është e mundur.

9. “Pragu i alarmit” është niveli, përtej të cilit një ekspozim i shkurtër i popullsisë në tërësi rrezikon shëndetin publik dhe për të cilin autoritetet kompetente duhet të marrin masa të menjëhershme.

10. “Pragu i informacionit” është niveli, përtej të cilit një ekspozim i shkurtër i grupeve veçanërisht të prekshme të popullsisë rrezikon shëndetin dhe për të cilin nevojitet informacion i menjëhershëm dhe i përshtatshëm.

11. “Kontributi nga burimet natyrore” janë shkarkimet e ndotësve që nuk shkaktohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga aktivitetet e njeriut, përfshirë dukuritë natyrore, si: shpërthimet vullkanike, aktivitetet sizmike, aktivitetet gjeotermike, zjarret e tokave të pakultivuara, dukuritë e erës së fortë, spërkatjet detare, rizezullimi atmosferik, rrezatimi radioaktiv ose nga transporti i lëndës natyrore nga rajonet e thata.

12. “Zonë” është një pjesë e kufizuar e territorit të Republikës së Shqipërisë për qëllime të vlerësimit dhe menaxhimit të cilësisë së ajrit.

13. “Aglomerat” është një zonë me densitet popullsie prej më shumë se 3 000 banorë/km<sup>2</sup>.

14. “Ministër” është ministri përgjegjës për mjedisin.

15. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.

16. “Publiku” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

17. “Njësia e qeverisjes vendore” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”.

18. “AKM”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

19. “ARM”, agjencitë rajonale të mjedisit, kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

20. “TSHMPU”, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.



## KREU II CILËSIA E AJRIT NË MJEDIS

### Neni 4

#### Autoritetet kompetente

Autoritetet kompetente, sipas fushës së përgjegjësisë, janë, përkatësisht:

1. Ministria është autoriteti kompetent:

a) për miratimin e sistemit të matjes (metodat, pajisjet, rrejetet dhe laboratorët);

b) për bashkërendimin ndërinstitucional të punës për çështje të ndryshme që lidhen me cilësinë e ajrit;

c) për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për çështje të ndryshme që lidhen me cilësinë e ajrit.

2. AKM-ja është autoriteti kompetent:

a) për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis;

b) për sigurimin e saktësisë së matjeve;

c) për analizimin e metodave të vlerësimit.

3. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për masat që duhen marrë në kuadër të legjislacionit të tyre të posaçëm, të cilat çojnë në ruajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit.

4. Ministrinë e linjës janë përgjegjëse për masat që duhen marrë në kuadër të legjislacionit të tyre të posaçëm, të cilat çojnë në ruajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit.

### Neni 5

#### Vlerësimi i cilësisë së ajrit në mjedis për disa ndotës

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton vendimin që parashikon rregullat për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit, në lidhje me ndotësit që listohen në aneksin I, përfshirë detyrimet në lidhje me vlerat kufi, vlerat e synuara, pragun e alarmit, pragun e informacionit dhe nivelet e tyre, si dhe kërkesën për pakësimin e ekspozimit kombëtar ndaj PM<sub>2,5</sub>.

### Neni 6

#### Përcaktimi i zonave dhe aglomerateve

1. Për qëllime të këtij ligji, territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në zona dhe aglomerate.

2. Ministri, me propozim të Drejtorit të AKM-së, miraton me urdhër zonat dhe aglomeratet, sipas pikës 1, të këtij neni. Ky urdhër publikohet në Fletoren Zyrtare.

3. Për të gjitha zonat dhe aglomeratet kryhet vlerësimi i cilësisë së ajrit, sipas rregullave për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 5, dhe menaxhimi i cilësisë së ajrit, sipas neneve 7 dhe 8 të këtij ligji.

### Neni 7

#### Planet e cilësisë së ajrit

1. Plani i cilësisë së ajrit përgatitet dhe zbatohet kur nivelet e dyoksidit të squfurit, dyoksidit të azotit, benzenit, monoksidit të karbonit, plumbit, lëndës së ngurtë pezull ose ozonit në ajrin e mjedisit, kalojnë vlerat kufi apo vlerat e synuara respektive, të përcaktuara sipas nenit 5 të këtij ligji. Gjatë hartimit të planit merret parasysh kufiri përkatës i tolerancës, pavarësisht nëse ka kapërcyer ose jo data e arritjes së vlerës kufi apo vlerës së synuar respektive. Planet e cilësisë së ajrit për kapërcimet e PM<sub>10</sub> përgatiten vetëm për ato zona dhe aglomerate ku kapërcimet shkaktohen nga burime të ndryshme nga ato natyrore apo nga hedhja e rërës apo kripës në rrugë gjatë dimrit. Plani i cilësisë së ajrit, përfshin gjithashtu monitorimin e treguesve të ndotjes së ajrit në *hot spot*-et e identifikuar.

2. Kur koha e arritjes së një vlere kufi ka kaluar, plani i cilësisë së ajrit duhet të përcaktojë masat e nevojshme për të siguruar sa më parë të jetë e mundur përputhshmërinë me vlerën kufi.

3. Plani i cilësisë së ajrit përfshin të paktën informacionin e listuar në seksionin A, të aneksit II, bashkëlidhur këtij ligji.

4. Plani i cilësisë së ajrit mund të përfshijë masa specifike që synojnë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullsisë, përfshirë fëmijët.

5. Plani i cilësisë së ajrit mund të përfshijë masa në mbështetje të planeve të veprimit afatshkurtër.

6. Plani i cilësisë së ajrit, sipas rastit, mund të përgatitet si një plan i integruar i cilësisë së ajrit, kur kërkohet të përfshijë më shumë ndotës se ata të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

7. Planet e cilësisë së ajrit, kurdo që është e mundur, duhet të jenë në përputhje me planet e tjera ekzistuese lidhur me kufizimin e shkarkimeve në ajër nga impiantet e mëdha me djegie, tavanet kombëtare të shkarkimeve në ajër apo zhurmave në mjedis.



8. Plani i aglomeratit dhe plani i zonës, kur zona është pjesë e një aglomerati ose e një bashkie, përgatitet nga bashkia përkatëse dhe miratohet nga këshilli bashkiak.

9. Kur zona përbëhet nga më shumë se një aglomerat dhe/ose bashki, plani i zonës përgatitet nga bashkitë dhe miratohet nga këshillat bashkiakë përkatës ose miratohet një plan i përbashkët ndërvendor.

10. Plani kombëtar i cilësisë së ajrit miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, menjëherë pas fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, rishikohet çdo 6 vjet dhe ndryshohet kur gjykohet e nevojshme.

11. Ministria dhe/ose bashkia/bashkitë, kur përgatitin planet e cilësisë së ajrit, bashkëpunojnë me ministritë e linjës, AKM-në, ARM-të dhe ISHMPU-në. Ministritë e linjës, AKM-ja, ARM-të dhe ISHMPU-ja sigurojnë të gjithë informacionin përkatës që disponojnë.

12. Ministria dhe/ose bashkia/bashkitë që propozojnë të përgatitin, të ndryshojnë ose të rishikojnë një plan të cilësisë së ajrit duhet të dërgojnë projektin e planit në AKM dhe në ministritë përkatëse për komente, të cilat do të merren në konsideratë për përmirësimin e tij. Konsiderohet se nuk ka komente, nëse ato nuk dërgohen brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës.

#### Neni 8

##### **Planet e veprimit afatshkurtër**

1. Autoritetet e përmendura në pikat 8, 9 dhe 10, të nenit 7, të këtij ligji, duhet të përgatitin dhe të zbatojnë planin e veprimit afatshkurtër në çdo rast kur në ndonjë zonë ose aglomerat ekziston rreziku që nivelet e ndotësve të kapërcejnë një apo më shumë nga pragjet e alarmit, të përcaktuar sipas vendimit të referuar në nenin 5 të këtij ligji.

2. Plani i veprimit afatshkurtër duhet të përcaktojë masat që do të merren në periudhën afatshkurtër për pakësimin e rrezikut të kapërcimit të pragjeve të alarmit dhe, në rast se ato janë kapërcyer, për shkurtimin e kohëzgjatjes së një incidenti të tillë.

3. Bashkia/bashkitë përgatit/përgatitin dhe zbaton/zbatojnë një plan veprimi afatshkurtër për një zonë apo aglomerat kur ka rrezik të kapërcehet

pragu i alarmit për ozonin, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, referuar në nenin 5, të këtij ligji, vetëm nëse ato vlerësojnë se duke marrë parasysh kushtet gjeografike, meteorologjike dhe ekonomike të vendit, ka shumë mundësi për reduktimin e rrezikut, kohëzgjatjes apo masës së këtij kapërcimi. Në këto raste planet afatshkurtra mbajnë parasysh edhe kërkesat që lidhen me arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe benzo(a)pirenin.

4. Bashkia/bashkitë mund të përgatitë /përgatitin, sipas rastit, plane të veprimit afatshkurtër, kur ekziston rreziku që të kapërcehen një ose më shumë vlera kufi apo vlera të synuara, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave referuar në nenin 5 të këtij ligji.

5. Planet e veprimit afatshkurtër, të përmendura në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të këtij neni, rast pas rasti, mund të kërkojnë masa efektive për të kontrolluar dhe, kur është e nevojshme, për të pezulluar aktivitetet që kontribuojnë në rrezikun e kapërcimit të vlerave kufi, vlerave të synuara apo të pragut të alarmit përkatës. Ato mund të përfshijnë masa për trafikun e automjeteve, punimet e ndërtimit, anijet e ankoruara, përdorimin e impianteve apo produkteve industriale dhe atyre të ngrohjes.

6. Planet mund të përfshijnë edhe veprime specifike që synojnë mbrojtjen e grupeve më të prekshme të popullsisë, përfshirë edhe fëmijët.

7. Ministria dhe/ose bashkia/bashkitë që propozojnë të përgatitin, të ndryshojnë ose të rishikojnë një plan veprimi afatshkurtër, sipas pikave 1, 3 e 4, të këtij neni, duhet të dërgojnë projektin e planit në AKM dhe në ministritë përkatëse për komente, të cilat do të merren në konsideratë për përmirësimin e tij. Konsiderohet se nuk ka komente, nëse ato nuk dërgohen brenda 30 ditëve pune nga marrja e kërkesës.

#### Neni 9

##### **Pjesëmarrja e publikut në përgatitjen e planeve të cilësisë së ajrit dhe planeve të veprimit afatshkurtër**

1. Ministria ose bashkia/bashkitë publikojnë projektplanin e cilësisë së ajrit ose planin e veprimit afatshkurtër të ri, të ndryshuar apo të rishikuar, në faqet e tyre elektronike zyrtare, dhe e bëjnë të disponueshëm për komente për publikun.

2. Pas publikimit, sipas pikës 1, të këtij neni, ministria përgjegjëse për mjedisin dhe/ose bashkia/bashkitë duhet:



a) të informojnë publikun për propozimin dhe çdo informacion përkatës të mëtejshëm;

b) të informojnë publikun për të drejtën e tij për të marrë pjesë në përgatitjen e planit;

c) të përcaktojnë metodat, sipas të cilave publiku mund të marrë pjesë në këshillim;

ç) të përcaktojnë kohën e arsyeshme për këshillim;

d) të përcaktojnë adresën ku duhet të dërgohen komentet;

dh) të informojnë rreth përmbajtjes së planit.

3. Ministria dhe/ose bashkia/bashkitë, gjatë përgatitjes së planit, marrin parasysh rezultatet e konsultimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Këshilli i Ministrave dhe këshillat bashkiakë miratojnë planin kombëtar ose planin e zonës apo aglomeratit pasi sigurohen se pjesëmarrja e publikut dhe këshillimi me të janë kryer në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin e posaçëm.

5. Plani, pasi miratohet, publikohet në faqet elektronike zyrtare të ministrisë dhe/ose bashkisë/bashkive.

#### Neni 10

##### Informimi i publikut për cilësinë e ajrit

1. Ministria duhet të bëjë rregullisht të disponueshëm për publikun dhe organizatat e interesuara informacionin e mëposhtëm:

a) për cilësinë e ajrit në mjedis sipas kërkesave të përmendura në aneksin III, bashkëlidhur këtij ligji;

b) për çdo shtyrje afati për përputhshmërinë me vlerat kufi për dyoksidin e azotit apo benzenin, sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave referuar në nenin 5 të këtij ligji;

c) për çdo përjashtim nga afatet për përputhshmërinë me vlerat kufi për PM10, sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave, referuar në nenin 5 të këtij ligji;

ç) për planet e cilësisë së ajrit;

d) për planet e veprimit afatshkurtër (përfshirë, sipas rastit, fizibilitetin, përmbajtjen dhe zbatimin e tyre);

dh) çdo kapërcim të secilës vlerë të synuar gjatë vitit, arsyet përkatëse dhe zonën ku ai ka ndodhur;

e) raportet vjetore për të gjithë ndotësit e përmendur në aneksin I, bashkëlidhur këtij ligji, të hartuar sipas kërkesave të nenit 11 të tij;

ë) një vlerësim të shkurtër për vlerat e synuara dhe efektet në shëndet dhe në mjedis.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1, të këtij neni, duhet të jetë:

a) falas;

b) i qartë dhe i kuptueshëm;

c) i disponueshëm në kohën e duhur;

ç) i disponueshëm nëpërmjet çdo lloj medieje lehtësisht të aksesueshme, përfshirë shtypin, internetin ose mjet tjetër të përshtatshëm telekomunikimi.

3. Organizatat e interesuara përfshijnë, në veçanti:

a) organizatat mjedisore;

b) organizatat e konsumatorëve;

c) organizatat që përfaqësojnë interesat e grupeve më të prekura të popullsisë;

ç) organet e tjera të kujdesit shëndetësor; dhe

d) industrinë përkatëse, tregtarët, shoqëritë tregtare dhe ente të tjera juridike.

#### Neni 11

##### Raportet vjetore të vlerësimit të cilësisë së ajrit në mjedis

1. Raporti vjetor i vlerësimit të cilësisë së ajrit në mjedis për ndotësit e referuar në aneksin I, bashkëlidhur këtij ligji, përgatitet nga AKM-ja, sipas kërkesave të vendimit të referuar në nenin 5 të këtij ligji.

2. Të dhëna të tilla duhet të përfshijnë, për periudhën mesatare përkatëse:

a) informacion të detajuar për të gjitha rastet, kur nivelet e ndotësve kanë kapërcyer vlerat kufi dhe, sipas rastit, atë plus marzhin e tolerancës;

b) informacion të detajuar për të gjitha rastet, kur nivelet e ndotësve kanë kapërcyer vlerat e synuara ose nivelet kritike;

c) informacion të detajuar për të gjitha rastet, kur nivelet e ndotësve kanë kapërcyer objektivat afatgjatë;

ç) informacion të detajuar për të gjitha rastet, kur nivelet e ndotësve kanë kapërcyer pragjet e informacionit;

d) informacion të detajuar për të gjitha rastet, kur nivelet e ndotësve kanë kapërcyer pragjet e alarmit;

dh) një vlerësim përmbledhës të efekteve si rezultat i rasteve të përmendura në shkronjat “a” deri në “d” të kësaj pike;

e) informacioni i kërkuar sipas shkronjave “a” deri në “dh”, të kësaj pike, përfshin edhe:



i) listën e zonave dhe aglomerateve (në raportin e parë) apo ndryshimet që u janë bërë atyre (nga raporti i dytë e në vijim);

ii) listën e zonave dhe aglomerateve ku ka pasur kapërcime;

iii) sipërfaqen e territorit ku ka pasur kapërcime;

iv) vlerat e përqendrimit të ndotësve në këto territore dhe, nëse është e rëndësishme, edhe datat e periudhat kur ato janë konstatuar;

v) arsyet pse ka ndodhur çdo kapërcim dhe burimet që kanë kontribuar;

vi) popullsinë e ekspozuar ndaj këtyre kapërcimeve;

vii) masat e marra për moskapërcimin e vlerave të synuara në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, referuar nenit 5 të këtij ligji.

3. Raportet vjetore mund të përfshijnë edhe:

a) një vlerësim të niveleve të vlerësuara për të parë kontributet nga burimet natyrore dhe rizezullimin e lëndës pezull, si rezultat i shtrimit të rrugëve me rërë ose kripë;

b) informacion të mëtejshëm dhe vlerësime për mbrojtjen e pyjeve.

4. Ministri miraton, me udhëzim, formatin që do të përdoret për raportimin vjetor për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis, sipas këtij neni.

5. Afati i dorëzimit të këtij raporti është brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës. Raporti i parë përgatitet për vitin kalendarik kur fillon efektet juridike vendimi i Këshillit të Ministrave, referuar në nenin 5 të këtij ligji.

6. Raportet vjetore miratohen me urdhër të ministrit.

### KREU III SHKARKIMET NË AJËR

Neni 12

#### Shkarkimi nga burime të palëvizshme

Kërkesat për pakësimin e shkarkimit në ajër nga burime të palëvizshme, si dhe vlerat kufi të ndotësve për këto burime përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 13

#### Shkarkimi nga burimet e lëvizshme

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton vendimin për

masat që duhet të merren kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton vendimin për masat që duhet të merren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jorrugore.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton vendimin për masat që duhen marrë për reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe ata me ndezje pozitive që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

Neni 14

#### Pakësimi i shkarkimeve në ajër nga përdorimi i lëndëve djegëse

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për industrinë, miraton:

a) vendimin për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe dizel;

b) vendimin për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor);

c) vendimin për masat lidhur me sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO<sub>2</sub> gjatë marketingut të automjeteve të reja.

Neni 15

#### Pakësimi i shkarkimeve në ajër nga përbërësit organikë të avullueshëm

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për industrinë, miraton:

a) vendimin për masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime;

b) vendimin për masat për kufizimin e përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i përbërësve organikë në disa bojëra, llake dhe produkte për lustrimin e automjeteve;



c) vendimin për masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarja e saj nga terminalët në pikat e shitjes;

ç) vendimin për kapjen e avujve të benzinës në fazën e dytë gjatë rimbushjes së automjeteve në pikat e shitjes.

Neni 16

#### **Pakësimi i shkarkimeve në ajër përmes zhvillimit të infrastrukturës rrugore**

Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e infrastrukturës, kudo që është e mundur, marrin të gjitha masat që mundësojnë alternativa të ndryshme të qarkullimit rrugor, në mënyrë që të pakësohet ndotja e ajrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës.

Neni 17

#### **Programi kombëtar i pakësimit të shkarkimeve në ajër**

1. Ministria harton programin kombëtar për pakësimin e vazhdueshëm të shkarkimeve të përgjithshme vjetore nga burimet e lëvizshme dhe të palëvizshme. Këto programe përcaktojnë afatet kohore dhe masat që zbatohen për pakësimin e shkarkimeve.

2. Programet e pakësimit të shkarkimeve sigurojnë respektimin e taveve kombëtare të shkarkimeve ose përqindjet e pakësimit të ndotësve të caktuar.

3. Programi i pakësimit të shkarkimeve mund të rishikohet në përputhje me kushtet e reja të krijuara. Rishikimi mund të përfshijë rishikimin e taveve të shkarkimeve ose të datave të vendosura për respektimin e këtyre taveve.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër.

#### **KREU IV**

#### **NDOTJA NDËRKUFITARE E AJRIT**

Neni 18

#### **Ndotja ndërkufitare e ajrit**

1. Ministria bashkëpunon me autoritetet kompetente të shteteve fqinje përkatëse kurdoherë që një prag alarmi, vlerë kufi apo vlerë

e synuar së bashku me kufirin e tolerancës ose objektivin afatgjatë përkatës është kapërcyer për shkak të transferimit ndërkufitar të konsiderueshëm të ndotësve të ajrit apo prekursorëve të tyre dhe, kur është e nevojshme, përgatit aktivitete të përbashkëta, përfshirë plane të përbashkëta ose të bashkërenduara për cilësinë e ajrit, me qëllim që të zbusë këto kapërcime përmes zbatimit të masave të duhura, por në mënyrë proporcionale.

2. Ministria, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, referuar marrëveshjes dy ose shumëpalëshe, përgatit dhe zbaton, sipas rastit, plane të përbashkëta veprimi afatshkurtër që mbulojnë zonat fqinje në ato shtete.

3. Ministria siguron që autoritetit kompetent të zonës fqinje të një shteti tjetër, i cili përgatit plan veprimi afatshkurtër, t'i jepet i gjithë informacioni i duhur.

4. Ministria u siguron informacion, sa më shpejt të jetë e mundur, autoriteteve kompetente përkatëse të shtetit/shteteve fqinje/fqinje kurdo që kapërcehen pragjet e informacionit ose të alarmit në zona dhe aglomerate të Republikës së Shqipërisë që ndodhen pranë kufirit të saj.

5. Informacioni i përmendur në pikën 4, të këtij neni, bëhet njëkohësisht i disponueshëm edhe për publikun.

6. Ministri, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të shteteve fqinje, informon publikun, sa më shpejt të jetë e mundur, edhe kur kapërcehen pragjet e informacionit ose të alarmit në zona dhe aglomerate fqinje jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

#### **Raportimi mbi zbatimin e këtij ligji**

1. Ministria përgatit, çdo tre vjet, raportin për zbatimin e këtij ligji.

2. Raporti përfshin informacion mbi planet e cilësisë së ajrit dhe mbi progresin e arritur nga zbatimi i tyre.

3. AKM-ja, ISHMPU-ja dhe institucione të tjera i sigurojnë ministrisë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e raportit.

4. Raporti i përmendur në pikën 1, të këtij neni, miratohet me urdhër të ministrit, publikohet në faqen zyrtare të ministrisë dhe bëhet i disponueshëm për publikun.



5. Ministri përcakton me urdhër formatin për përgatitjen e raportit, sipas pikës 1, të këtij neni, së bashku me informacionin që duhet të përmbajë ky raport.

## KREU V KUNDËRVAJTJET

### Neni 20 Kundërvajtjet

1. Çdo shkelje e kërkesave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, kur nuk përbën vepër penale, konsiderohet shkelje administrative dhe ndëshkohet me gjobë, pezullim apo mbyllje të veprimtarisë, përkatësisht:

a) mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të shkarkimeve në ajër nga operatori i një instalimi, referuar lejes së mjedisit të tipave A, B apo C:

i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë;

ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën 300 000 (treqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

iii) për lejet e mjedisit të tipit C, dënohet me gjobë në vlerën 300 000 (treqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

b) prodhimi, importimi ose tregtimi, nga subjektet, i lëndëve djegëse në kundërshtim me kërkesat e nenit 14, të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, në varësi të sasisë dhe rrezikshmërisë që paraqesin lëndët djegëse të palejuara, si dhe me sekuestrimin e lëndës djegëse që është gjendje;

c) përdorimi i lëndëve djegëse të ndaluara nga operatori, në kundërshtim me kërkesat e neneve 14 dhe 15, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë, në varësi të sasisë e rrezikshmërisë që ato lëndë djegëse paraqesin, si dhe me pezullimin e veprimtarisë, për aq kohë sa të bëhet zëvendësimi i lëndës djegëse;

ç) ndotja e ajrit, e shkaktuar nga burimet e lëvizshme, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Organi që vendos gjobën dhe bën ekzekutimin e saj, si dhe pezullimin ose ndërprerjen e veprimtarisë, sipas këtij neni, është inspektorati përgjegjës për mjedisin.

3. Në rastet kur shkeljet përbëjnë vepër penale, inspektorati përgjegjës për mjedisin bën kallëzim penal pranë organeve përkatëse.

### Neni 21 Ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative

1. Ekzekutimi i masave administrative bëhet në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative.

2. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ankimit të masave administrative bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Të ardhurat nga vjelja e gjobave dhe të ardhura të tjera, të mbledhura në përputhje me dispozitat e këtij ligji derdhen në masën 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

## KREU VI DISPOZITA KALIMTARE

### Neni 22 Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, 13, 14 dhe 15, të këtij ligji, brenda 3 vjetëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

2. Ministri, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 2, 19, pika 5, dhe 11, pikat 4 e 6, të tij.

### Neni 23 Shfuqizime

Me fillimin e efekteve juridike të këtij ligji shfuqizohen këto akte:

a) ligji nr. 8897, datë 16.5.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar;

b) aneksi 2.1 i vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 435, datë 12.9.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimit në ajër në Republikën e Shqipërisë”.



Neni 24  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8863, datë 26.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani**

**ANEKSI I**

Lista e ndotësve të ajrit:

Ky ligj zbatohet të paktën për ndotësit e ajrit të mëposhtëm:

Grupi i parë

1. Dyoksidi i squfurit (SO<sub>2</sub>)
2. Dyoksidi i azotit (NO<sub>2</sub>)
3. Oksidi i azotit (NO<sub>x</sub>)
4. Lënda e ngurtë pezull (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2,5</sub>)
5. Plumb (Pb)

Grupi i dytë

6. Ozoni (O<sub>3</sub>)

Grupi i tretë

7. Benzeni
8. Monoksidi i karbonit (CO)
9. Hidrokarbure aromatike policiklike (PAHs)
10. Kadmiumi (Cd)
11. Arseniku (As)
12. Nikeli (Ni)
13. Mërkuri (Hg)

**ANEKSI II**

**INFORMACIONI QË DUHET PËRFSHIRË NË PLANET LOKALE, RAJONALE DHE KOMBËTARE TË CILËSISË SË AJRIT PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT TË MJEDISIT**

Seksioni A

1. Lokalizimi i ndotjes së tepërt:

- a) rajoni;
- b) qyteti (harta);
- c) stacioni i matjes (harta, koordinatat gjeografike).

2. Informacioni i përgjithshëm:

- a) lloji i zonës së monitorimit të cilësisë së ajrit (qytet, zonë industriale apo rurale);
- b) vlerësimi i zonës së ndotur (km<sup>2</sup>) dhe i popullsisë së ekspozuar ndaj ndotjes;
- c) të dhënat klimatike të nevojshme;
- ç) të dhëna përkatëse të topografisë;

d) informacioni i mjaftueshëm për llojin e synimeve që kërkojnë mbrojtje në zonë.

3. Autoritetet përgjegjëse

Emrat dhe adresat e personave përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të përmirësimit.

4. Natyra dhe vlerësimi i ndotjes:

a) përqendrimet e vëzhguara gjatë viteve të mëparshme (përpara zbatimit të masave të përmirësimit);

b) përqendrimet e matura që nga fillimi i projektit;

c) teknikat e përdorura për vlerësim.

5. Origjina e ndotjes:

a) lista e burimeve kryesore të shkarkimeve përgjegjëse për ndotjen (harta);

b) sasia totale e shkarkimeve nga këto burime (ton/vit);

c) informacion për ndotjen e importuar nga rajone të tjera.

6. Analiza e situatës:

a) informacioni i detajuar mbi faktorët përgjegjës për kalimin (p.sh. transporti, përfshirë transportin ndërkuftar, formimin e ndotësve dytësorë në atmosferë);

b) informacioni i detajuar mbi masat e mundshme për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

7. Informacioni i detajuar mbi masat ose projektet për përmirësim që kanë ekzistuar përpara datës së miratimit të këtij ligji, që do të thotë:

a) masat lokale, rajonale, kombëtare, ndërkombëtare;

b) efekte të vëzhguara të këtyre masave.

8. Informacioni i detajuar mbi masat ose projektet e miratuara, me synimin për të pakësuar ndotjen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji:

a) lista dhe përshkrimi i të gjitha masave të përcaktuara në projekt;

b) grafiku i zbatimit;

c) vlerësimi i përmirësimit të planifikuar të cilësisë së ajrit dhe i kohës së nevojshme për të arritur këta objektiva.

9. Informacioni i detajuar mbi masat ose projektet e planifikuara ose të kërkuara për periudha afatgjata.

10. Lista e botimeve, dokumenteve, punës së bërë etj., që janë përdorur për të plotësuar informacionin e kërkuar sipas këtij aneksi.



### ANEKSI III INFORMIMI I PUBLIKUT

1. Ministria siguron që informacioni i përditësuar për përqendrimet e ndotësve në mjedis, mbuluar nga ky ligj, bëhet i disponueshëm për publikun në mënyrë rutinë.

2. Përqendrimet e siguruara në ajrin e mjedisit duhet të paraqiten si vlera mesatare, në përputhje me periudhën mesatare të përshtatshme, siç përcaktohet në vendimin e referuar në nenin 5 të këtij ligji. Informacioni duhet të paktën të tregojë çdo nivel që kalon objektivat e cilësisë së ajrit, përfshirë vlerat kufi, vlerat e synuara, pragjet e alarmit, pragjet e informacionit apo objektivat afatgjatë të ndotësve të referuar në këtë ligj. Gjithashtu duhet të sigurojë një vlerësim të shkurtër në lidhje me objektivat e cilësisë së ajrit dhe informacionin e duhur në lidhje me efektet mbi shëndetin ose, sipas rastit, mbi bimbësinë.

3. Informacioni për përqendrimet në mjedis të dyoksidit të squfurit, dyoksidit të azotit, lëndës së ngurtë pezull (të paktën PM10), ozonit dhe monoksidit të karbonit duhet të përditësohet të paktën çdo ditë dhe, kur është e mundur, informacioni duhet të përditësohet çdo orë. Informacioni për përqendrimet në mjedis të plumbit dhe benzenit, paraqitur si vlerë mesatare për 12 muajt e fundit, duhet të përditësohet çdo tre muaj dhe, kur është e mundur, çdo muaj.

4. Ministria siguron informacion në kohë për publikun mbi kapërcimet aktuale apo të parashikuara të çdo pragu të alarmit dhe të informacionit. Ky informacion duhet të përfshijë të paktën sa më poshtë:

a) Informacion për kapërcimin/kapërcimet e vëzhguara:

- i) vendin apo zonën përkatëse;
- ii) llojin e pragut të kapërcyer (të alarmit apo të informacionit);
- iii) kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen;
- iv) përqendrimin më të lartë në një orë, si edhe përqendrimin e mesatares më të lartë në tetë orë në rastin e ozonit;

b) Parashikimi për pasditen/ditën dhe ditët vijuese:

- i) zona gjeografike e kapërcimeve të pritshme të pragut të alarmit dhe/ose të informacionit;

ii) ndryshimet e pritshme në ndotje (përmirësimi, stabilizimi apo përkeqësimi), së bashku me arsyet për këto ndryshime.

c) Informacion për llojin e popullsisë në lidhje me të, efektet e mundshme në shëndet dhe sjelljen e rekomanduar:

- i) informacion për grupet e popullsisë në rrezik;
- ii) përshkrimin e simptomave mundshme;
- iii) masat paraprake që rekomandohen për popullsinë përkatëse;
- iv) ku të gjejnë informacion të mëtejshëm;

ç) Informacion për masat parandaluese për të pakësuar ndotjen dhe/ose ekspozimin ndaj saj; treguesin e sektorëve të burimeve kryesore; rekomandime për veprimet për pakësimin e shkarkimeve;

d) Në rastin e kalimeve të parashikuara, ministria merr masa për të siguruar sa më shumë të jetë e mundur përhapjen e këtyre informacioneve.

### LIGJ

Nr. 163/2014

### PËR URDHRIN E PUNONJËSVE SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

#### Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është rregullimi i organizimit dhe veprimtarisë së Urdhrit të Punonjësve Socialë, si dhe i marrëdhënieve juridike dhe etiko-profesionale të punonjësve socialë.

Neni 2

#### Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e profesionit të punonjësit social, garantimi i standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të



interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të punonjësit social.

Neni 3

### Fusha e zbatimit

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë punonjësit socialë që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik dhe atë privat.

Neni 4

### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punë sociale” është veprimtaria profesionale e bazuar te praktika, si dhe një disiplinë akademike që promovon ndryshimin, zhvillimin, kohezionin social dhe drejtësinë sociale, si dhe fuqizimin dhe pavarësimin e njerëzve.

2. “Punonjës social” është një profesion i rregulluar që ushtrohet në fushën e punës sociale, në nivel makro, mezo dhe mikro, në shërbim të individëve, familjeve, grupeve, komuniteteve, institucioneve të nivelit qendror e vendor në sistemin publik dhe privat.

Neni 5

### Statusi

Urdhri i Punonjësve Socialë është ent publik jobuxhetor i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

## KREU II

### MISIONI DHE BUXHETI

Neni 6

### Misioni

Misioni i Urdhrit është garantimi dhe ruajtja në vazhdimësi e standardeve dhe praktikave të mira të ushtrimit të profesionit në fushën e punës sociale dhe mbrojtja e publikut nga veprimet joprofessionale dhe joetike të punonjësve socialë.

Neni 7

### Kompetencat e Urdhrit të Punonjësve Socialë

Për realizimin e misionit të tij, Urdhri i Punonjësve Socialë ushtron këto kompetenca:

a) jep dhe heq të drejtën e ushtrimit individual të

profesionit të punonjësit social nëpërmjet dhënies dhe revokimit të licencës profesionale;

b) krijon dhe përditëson regjistra të posaçëm, sipas fushës së veprimtarisë dhe profileve;

c) miraton standarde etike të detyrueshme për punonjësit socialë, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre në praktikën profesionale;

ç) mbron të drejtat e anëtarëve të urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre, si dhe pavarësinë e ushtrimit të profesionit;

d) nxit në vazhdimësi punonjësit socialë në përdorimin e standardeve më të larta dhe të praktikave më të mira në fushën e punës sociale;

dh) kontribuon, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, për sigurimin e standardeve më të larta dhe praktikave më të mira në edukimin dhe formimin etik, profesional dhe shkencor të punonjësit social;

e) kontribuon, në marrjen e masave të nevojshme e të përshtatshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e mbrojtjes e mirëqenies sociale të popullatës;

ë) informon publikun përmes njoftimeve, buletineve periodike, botimeve shkencore dhe botimeve të tjera të veçanta, nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar;

f) kontribuon në zbatimin e programeve shtetërore, të enteve dhe organizatave të tjera publike e private, në funksion të interesit publik.

Neni 8

### Anëtarësimi në Urdhër

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e punonjësit social, në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm.

2. Janë anëtarë të Urdhrit të Punonjësve Socialë të gjithë punonjësit socialë që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e punonjësit social, sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Kërkesa minimale për formimin dhe kualifikimet profesionale për punonjësit socialë është që të zotërojnë një diplomë në fushën e punës sociale brenda ose jashtë vendit. Për kategori të ndryshme të formimit dhe të kualifikimeve profesionale të punonjësve



socialë, kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministritë përgjegjëse për çështjet sociale;

c) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim;

ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit, dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Punonjësit Social.

3. Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të punonjësit social në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të anëtarësohen paraprakisht në Urdhrin e Punonjësve Socialë të Republikës së Shqipërisë dhe të njohin të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë profesionin e punonjësit social. Punonjësi social, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (*Good Standing Certificate*) nga urdhri/dhoma apo shoqata e punonjësve socialë të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

c) njohjen e diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij;

ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Punonjësve Sociale.

Për punonjës social të huaj, i cili nuk njihet gjuhën shqipe, detyrimisht është kusht të punojë me përkthyes.

4. Anëtarët e Urdhrit kanë detyrim të paguajnë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifën e regjistrimit, të licencimit dhe për shërbime të tjera administrative.

5. Individëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, që, në momentin e hyrjes në fuqi të legjislacionit për profesionet e rregulluara për punonjës social, kanë të dokumentuar formimin dhe kualifikimin profesional për ushtrimin e këtij profesioni, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të këtij neni, u lind e drejta e menjëhershme e anëtarësimin në Urdhër.

## Neni 9

### Bashkëpunimi

1. Urdhri, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministritë përgjegjëse për çështjet sociale, arsimin, shëndetësinë, punët e brendshme, drejtësinë dhe institucionet e tyre të varësisë, institucionet e pavarura dhe organizmatë tjerë, publikë ose privatë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Punonjësve Socialë informon çdo 6 muaj ministritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe ecurinë e tyre në të gjitha shkallët e gjykimin profesional.

3. Inspektoratet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bashkëpunojnë me Urdhrin gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni bashkëpunojnë me Urdhrin për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumenteve të rëndësishme në fushën e shërbimeve sociale dhe punës sociale.

## Neni 10

### Buxheti

1. Urdhri i Punonjësve Socialë ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe e administron Këshilli Kombëtar në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky Këshill.

2. Burimet financiare të Urdhrit të Punonjësve Socialë janë të ardhurat nga:

a) kuotizacionet e anëtarëve, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe janë të detyrueshme për çdo anëtar;

b) tarifën e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Të ardhurat e siguruar, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.



### KREU III ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

#### Neni 11

##### Organet kryesore

1. Organet kryesore të Urdhrit të Punonjësve Socialë janë:

- a) Asambleja e Urdhrit;
- b) Këshilli Kombëtar i Urdhrit;
- c) Kryetari i Urdhrit;
- ç) Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional.

2. Organet kryesore të Urdhrit shtrihen edhe në nivelin e qarkut, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e Urdhrit.

#### Neni 12

##### Asambleja e Urdhrit

1. Asambleja e Urdhrit është organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrës i Urdhrit dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.

2. Mbledhja e asamblesë thirret nga:

- a) Kryetari i Këshillit Kombëtar;
- b) kur kërkohet nga 1/5 e të gjithë anëtarëve të asamblesë.

3. Procedurat e vendimmarrjes dhe funksionimit të Asamblesë së Urdhrit rregullohen në statutin e Urdhrit.

#### Neni 13

##### Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 15 anëtarë, ndër të cilët 9 janë të zgjedhur nga Asambleja dhe 6 të tjerët janë përkatësisht Kryetari i Urdhrit, zëvendësi i tij, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, një përfaqësues me rotacion nga ministrinë e përmendura në pikën 1, të nenit 9, të këtij ligji, një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë të shkencave të punës sociale, një përfaqësues nga shoqatat e punonjësve socialë, të caktuar nga Kryetari i Urdhrit, sipas kritereve të përcaktuara në statut.

2. Këshilli Kombëtar ka këto kompetenca:

- a) miraton strukturën e vet organizative;
- b) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit;
- c) miraton statutin, rregulloret e Urdhrit si dhe Kodin Etik Deontologjik të Punonjësit Social;

ç) zgjedh Kryetarin e Urdhrit dhe zëvendësin e tij;

d) mban dhe përditëson Regjistrin e Punonjësve Socialë të Urdhrit;

dh) mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Urdhrit që varen prej tij;

e) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontroleve për ushtrimin e profesionit të punonjësit social.

3. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 3 vjet.

#### Neni 14

##### Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë

1. Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë është kryetari i Këshillit Kombëtar dhe përfaqëson Urdhrit në marrëdhëniet me palët e treta.

2. Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja, midis jo më pak se dy kandidaturave alternative.

3. Mandati i Kryetarit të Urdhrit është 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për Kryetar të Urdhrit të Punonjësve Socialë duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë shtetas shqiptarë, rezidentë në Shqipëri;

b) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

c) të kenë jo më pak se pesë vjet përvojë në profesion, nga të cilat të paktën një vit ta kenë ushtruar gjatë pesë vjetëve të fundit;

ç) të kenë aftësi komunikuese, organizuese dhe drejtuese;

d) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;

dh) të mos jenë dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale.

5. Funksioni i Kryetarit të Urdhrit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.

6. Mandati i Kryetarit të Urdhrit mbaron para kohe në këto raste:

a) kur merret vendim nga Këshilli Kombëtar me votat e jo më pak se dy të tretave të anëtarëve;

b) kur jep dorëheqjen;

c) kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) kur humbet zotësinë e plotë për të vepruar;

d) kur bëhet i paaftë për arsye shëndetësore





për të kryer detyrën, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;

7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të Urdhrit të Punonjësve Socialë përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

Neni 15

### **Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional**

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional, i cili është organ i gjyimit profesional.

2. Komisioni verifikon dhe shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkëlqje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Punonjësit Social.

3. Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional përbëhet nga 7 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional përcaktohet në statut dhe në rregulloren e gjyimit profesional të Urdhrit.

Neni 16

### **Masat disiplinore**

1. Komisioni i Shqyrtimit Disiplinor Profesional heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe seancës dëgjimore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkëlqje të etikës, të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Profesionale ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë;
- ç) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Punonjësve Socialë deri në 3 vjet;

d) revokimin e licencës individuale profesionale dhe përjashtimin nga Urdhri për një periudhë deri në 3 vjet;

dh) propozim për shkarkim nga organet drejtuese.

2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si masë plotësuese komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese të përcaktuara me rregullore.

3. Masat disiplinore, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se, brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” dhe “b”, dhe, brenda 3 vjetësh nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “ç” dhe “d”, ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Neni 17

### **Ankimi**

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga Komisioni i Shqyrtimit Disiplinor Profesional paraqiten pranë këtij komisioni brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

2. Komisioni i Shqyrtimit Disiplinor Profesional, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit Disiplinor Profesional është përfundimtar.

3. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit Disiplinor Profesional ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 18

### **Organizimi i zgjedhjeve të para**

1. Ministri përgjegjës për çështjet sociale, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm, detyra e të cilit është të organizojë zgjedhjet e para të urdhrit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar të Urdhrit, komisioni i përkohshëm shkrihet automatikisht.

Neni 19

### **Dispozita kalimtare për individët që ushtrojnë profesionin e punonjësit social dhe profesione të tjera të punës sociale**

1. Individët që, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë ose kanë ushtruar profesionin e punonjësit social për një periudhë të caktuar kohe, por nuk kanë formimin dhe kualifikimin profesional minimal, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 8, të këtij ligji, mund të vazhdojnë



ushtrimin e profesionit të punonjësit social për një afat të caktuar, por janë të detyruar të ndjekin programe të formimit dhe kualifikimit/rikualifikimit profesional, të përshtatshme për ushtrimin e profesionit të tyre.

2. Procedurat, kriteret dhe afatet për ndjekjen e programeve të formimit dhe kualifikimit/rikualifikimit profesional, si dhe afatet brenda të cilave individët, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të vazhdojnë të ushtrojnë profesionin e punonjësit social, së bashku me të drejtat, detyrimet dhe kushtëzimet e mundshme që këta individë mund të kenë në marrëdhënie me administratën publike dhe private, ashtu si dhe me vetë Urdhrin, si pasojë e mangësive të tyre në formimin dhe kualifikimin profesional, si dhe periudha e eksperiencës së punës, e nevojshme për të lindur e drejta për vazhdimin e ushtrimit të profesionit, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe dokumentacioni i nevojshëm për vërtetimin e saj, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Individët, sipas pikës 1, të këtij neni, regjistrohen përkohësisht në një regjister të posaçëm të Urdhrit deri në përmbyshjen e kriterëve të nevojshme të anëtarësimit.

Neni 20

#### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të shkronjës “b”, pika 2, të nenit 8, dhe të pikës 2, të nenit 19, të këtij ligji.

Neni 21

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8864, datë 26.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani**

## **LIGJ**

**Nr. 164/2014**

### **PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 7, kudo në përmbajtje hiqen fjalët “në burim”.

Neni 2

Neni 21 riformulohet si më poshtë:

“Neni 21

#### **Shpërblimet e personelit dhe shpenzimet për investime**

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihet deri në 2 për qind të të ardhurave tatimore të mbledhura, për t'u përdorur për investime për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së mbledhjes së të ardhurave dhe për shpërblime stimuluese të personelit të administratës tatimore.

2. Personelit të administratës tatimore i jepen shpërblime stimuluese për:

a) efektivitetin e shërbimit të kryer në organet tatimore;

b) kryerjen e një shërbimi me rrezikshmëri të veçantë.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat për miratimin e investimeve dhe dhënien e shpërblimeve.

4. Ministri i Financave me urdhër miraton çdo vit masën për investimet dhe për shpërblimet stimuluese të personelit, sipas pikës 1 të këtij neni.”.



## Neni 3

Në nenin 28, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore.”.

## Neni 4

Në nenin 44 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 6 shfuqizohet.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Administrata tatimore qendrore publikon në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe mban të përditësuar listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv.

Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj.”.

## Neni 5

Në nenin 47, në fillim të fjalisë, fjalët “Për taksën vendore të biznesit të vogël” zëvendësohen me fjalët “Për sistemin e taksave vendore”.

## Neni 6

Në nenin 54, pika 2, fjalët “mund të” hiqen.

## Neni 7

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 55

**Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale dhe për vendosjen e sistemeve të monitorimit të qarkullimit**

1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.

2. Tatimpaguesit në sektorë të veçantë të ekonomisë, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, janë të detyruar të instalojnë

dhe të përdorin sisteme të monitorimit të qarkullimit.

3. Këshilli i Ministrave miraton:

a) karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit;

b) sistemet e integruara të kompjuterizuara për transferimet dhe deklaratimet financiare;

c) sistemet e komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre;

ç) kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit, si dhe kushtet e heqjes së autorizimit për këto shoqëri;

d) rastet e përjashtimit.

4. Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit, elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale e të sistemeve të monitorimit të qarkullimit, distancën e ruajtjes së kuponit tatimor dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike e të shërbimit.”.

## Neni 8

Pas nenit 61 shtohet neni 61/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 61/1

**Dhënie informacioni për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare**

1. Me kërkesë të administratës tatimore, për qëllim të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet tatimore ose për qëllim të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat parashikojnë asistencë administrative në çështjet tatimore, të cilat janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, çdo person duhet të japë informacion në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën tatimore, përfshirë, por pa u kufizuar, në informacionin e mbajtur nga banka dhe institucione të tjera financiare.

2. Pa kufizuar detyrimet e parashikuara në pikën 1, zbatohen të njëjtat rregulla si për informacionin e dhënë për qëllime të zbatimit të legjislacionit tatimor vendas, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në bazë të të cilave kërkohet ky informacion.



3. Ministri i Financave miraton udhëzimin për procedurat për zbatimin e këtij neni.

4. Në rast mosdhënieje të informacionit, në përputhje me këtë nen, aplikohen penalitete, sipas nenit 126 “Mosdhënie e informacionit”.

#### Neni 9

Në nenin 68, pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t’u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me vlerë deri në 100 (njëqind) lekë, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero dhe për shuma të tilla nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.”.

#### Neni 10

Në nenin 72, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” riformulohen si më poshtë:

“ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.”.

#### Neni 11

Në nenin 73 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. E drejta e tatimpaguesit për të kërkuar rimbursimin e tepricës kreditore parashkruhet kur kanë kaluar 5 vjet nga data e dorëzimit të deklaratës tatimore, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.”.

#### Neni 12

Neni 75/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 75/1

#### **Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore**

1. Nëse personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, rezultojnë me tepricë kreditore dhe paraqesin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar

tepër, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, verifikon situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miraton tepricën kreditore si të rimbursueshme dhe, kur është e nevojshme, ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut. Paga e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

2. Mënyra dhe procedurat e hollësishme teknike për zbatimin e pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

#### Neni 13

Në nenin 90 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët “të mbajë një shumë” zëvendësohen me fjalët “të bllokojë një shumë”.

2. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Shuma e bllokuar kalon për llogari të administratës tatimore sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

#### Neni 14

Në nenin 96, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Të ardhurat nga shitjet përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes dhe më pas zbatohet radha e pagesës, në përputhje me nenin 79 të këtij ligji.”.

#### Neni 15

Në nenin 99, në fund të pikës 1, fjalët “për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare” zëvendësohen me fjalët “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### Neni 16

Në nenin 103, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për klasifikimin si të pambledhshëm të një pjese ose të të gjithë detyrimit tatimor, njësia përkatëse e borxhit i paraqet një relacion me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, sipas të cilit evidenton, në përputhje me këtë nen, çdo



dokumentacion dhe veprim të kryer për mbledhjen e detyrimit tatimor sipas këtij ligji dhe çdo dokumentacion tjetër për të gjitha aktivet dhe pasivet e tij, përfshirë edhe:

- a) të dhëna të hollësishme për të ardhurat dhe shpenzimet;
- b) të dhëna për fluksin e parasë dhe parashikimet për fluksin;
- c) vlerësimet e aktiveve;
- ç) deklaratat (pasqyrat) e fitimeve e të humbjeve dhe bilancet;
- d) listat e debitorëve e të kreditorëve;
- dh) një vlerësim të mundësisë për mbledhjen e borxheve.”.

## Neni 17

Në nenin 104, pika 1, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” shfuqizohet.
2. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) 3 vjet pasi ka kaluar në regjistrin pasiv, sipas nenit 44 të këtij ligji.”.

## Neni 18

Në nenin 105 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, shkronja “c” riformulohet si më poshtë:

“c) zbatimin e masave shtrënguese;”.

2. Në pikën 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.”.

3. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

“4. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi.”.

## Neni 19

Në nenin 107, pika 1, pas fjalëve “garanci bankare” shtohen fjalët “minimalisht 6 muaj, por jo më pak se afati, sipas të cilit vendimi ka marrë formë të prerë”.

## Neni 20

Në nenin 109, pika 2, fjalët “brenda 3 muajve” zëvendësohen me fjalët “brenda 60 ditëve”.

## Neni 21

Neni 112 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 112

### Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim

Përveç sanksioneve administrative, të parashikuara në ligje të tjera, mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave, dënohet për çdo shkelje me gjobë prej 10 000 lekësh për organizatat jofitimprurëse dhe për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe 15 000 lekësh për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin.”.

Neni 22

Në nenin 114, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”.

Neni 23

Neni 115 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 115

### Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore

1. Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar. Shumë e papaguar e detyrimit tatimor konsiderohet edhe deklarimi i pasaktë i tepricës kreditore, e cila llogaritet si diferencë e tepricës kreditore që duhej deklaruar me tepricën kreditore të deklaruar.”.

Neni 24

Neni 116 riformulohet si më poshtë:



“Neni 116

**Evazoni tatimor**

1. Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përlogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt.

2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, konsiderohet gjithashtu se kryejnë evazion tatimor duke kryer fshehje të të ardhurave, me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore, tatimpaguesit, për të cilët konstatohet se kryejnë këto shkelje dhe për të cilët janë aplikuar dënimet administrative në përputhje me:

- a) pikën 1, të nenit 119, të këtij ligji,
- b) pikën 3, të nenit 121, të këtij ligji;
- c) pikën 1, shkronjat “a” e “b”, të nenit 122, të këtij ligji.”.

Neni 25

Në nenin 119, pika 1, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.”.

2. Në fund të pikës shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve, pas aplikimit të dënimit administrativ, si në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e bërë kallëzimin penal për tatimpaguesin.”.

Neni 26

Në nenin 121, në fund të pikës 3 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, në përputhje me nenin 116, të këtij ligji, administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin.”.

Neni 27

Në nenin 122 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronjat “a”, “b”, “g” dhe “gj” ndryshohen si më poshtë:

“a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:

i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë ose që plotësojnë për herë të parë detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit të monitorimit të qarkullimit;

ii) nëse pas verifikimit të parë, sipas nënndarjes “i”, të këtij neni, konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë, ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit;

iii) çdo konstatim i mëpasshëm i mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit, si shkelje e përsëritur, konsiderohet evazion tatimor siç parashikohet në nenin 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke bërë kallëzim penal për tatimpaguesin;

b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:

i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

ii) për çdo konstatim (verifikim) tjetër pas verifikimit të parë, ku konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kuponin tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, sipas kërkesave të këtij ligji, që i nënshtrohet një dënimi administrativ me gjobë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;



iii) për çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas aplikimit të dy dënimeve administrative, si më sipër, që konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin;

g) nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë;

gj) nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale ose sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.”.

2. Kudo në përmbajtje të nenit, pas fjalëve “pajisjes fiskale” shtohen fjalët “dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit”.

#### Neni 28

Pas nenit 128 shtohet neni 128/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 128/1

#### Dënime të tjera

Për shkeljet e konstatuara në rastin kur përgjegjës për TVSH-në është personi i tatuësëm blerës nëpërmjet “autogarkesës së TVSH-së”, aplikohen dënimet si më poshtë:

a) Me gjobë në përputhje me nenin 118, të këtij ligji, kur ky person nuk ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për TVSH-në, por moslëshimi i faturës nuk sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.

b) Me gjobë në përputhje me nenin 124, të këtij ligji, kur vepron sipas shkronjës “a”, të këtij neni, por, në këtë rast, moslëshimi i faturës sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.

c) Me gjobë, në përputhje me pikën 1, të nenit 128, të këtij ligji, kur ky person ka lëshuar faturë tatimore jo në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin për TVSH-në.

ç) Me gjobë në përputhje me nenin 115, të këtij ligji, kur ky person i tatuësëm ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në dhe nuk e ka deklaruar atë duke sjellë pasoja në TVSH-në e pagueshme.”.

#### Neni 29

Në nenin 129, pika 1, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) kur banka nuk bllokoi shumën e kërkuar, ajo paguan gjobë të barabartë me 0,2 për qind në ditë të detyrimit të pambajtur, por jo më pak se 100 000 (njëqind mijë) lekë në ditë.”.

#### Neni 30

Në nenin 131, pika 1, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) kryen evazion tatimor siç parashikohet në pikën 2, të nenit 116, të këtij ligji.”.

2. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) me dashje nuk mbledh detyrimin tatimor dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ose nuk i paguan ato në buxhet.”.

#### Neni 31

#### Dispozita kalimtare

1. Të gjithë tatimpaguesit që, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, rezultojnë mosdeklarues për më shumë se 12 muaj të njëpasnjëshëm, transferohen automatikisht nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv të administratës tatimore.

2. Përfaqësuesit tatimorë që janë regjistruar në drejtorinë rajonale tatimore ose do të regjistrohen si të tillë deri më 31.12.2014, në përputhje me nenin 9, të këtij ligji, janë përgjegjës për të paguar detyrimin tatimor për TVSH-në dhe nuk do të çregjistrohen deri në përfundim të përmbushjes së detyrimit të tyre si përfaqësues tatimor.

#### Neni 32

Ky ligji botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015.

Miratuar në datën 4.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8865, datë 26.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani**



**LIGJ**  
**Nr. 165/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË  
HUAS NR. ALB-0028 NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM  
(IDB) PËR PJESËMARRJEN NË  
FINANCIMIN E PROJEKTIT TË  
RINDËRTIMIT TË RRUGËVE  
DYTËSORE DHE LOKALE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas nr. ALB-0028 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për pjesëmarrjen në financimin e projektit të rindërtimit të rrugëve dytësore dhe lokale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8866, datë 26.12.2014  
të Presidentit të Republikës Bujar Nishani**

Banka Islamike për Zhvillim  
Jeddah, Arabia Saudite

**SË BASHKU NE NDËRTOJMË NJË TË  
ARDHME MË TË MIRË**  
Ref.ALB-0028

\_\_\_\_/\_\_\_\_1435 H (\_\_\_\_/\_\_\_\_2014 G)

Zëvendësministër i Financave  
(Guvernatori i IDB-së)  
Ministria e Financave

Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4  
Tiranë, Republika e Shqipërisë  
Tel: (355-4) 222 8373  
Fax: (355-4) 225 8435

I nderuar z. Erjon Luçi,

**Letërndryshimi për marrëveshjen e huas nr. ALB-0028 për pjesëmarrjen në financimin e projektit të rindërtimit të rrugëve dytësore dhe lokale, të nënshkruar më 19.7.143 1H (1.7.2010G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim**

1. Banka Islamike për Zhvillim (më poshtë quhet “Banka”) i ka dhënë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë e quajtur “Qeveria”) një financim me hua (Banka dhe Qeveria më poshtë së bashku quhen “Palët”) nëpërmjet marrëveshjes së huas të nënshkruar më 19.7.1431H (1.7.2010 G) (më poshtë quhet “Marrëveshja”) për pjesëmarrjen në financimin e projektit të rindërtimit të rrugëve dytësore dhe lokale (më poshtë quhet “Projekti”) sipas kushteve të specifikuar në Marrëveshje.

2. Qeveria, nëpërmjet shkresës së saj nr. 7507/1, datë 14.5.2013 G ka kërkuar, dhe Banka ka rënë dakord, të rishikohet plani i financimit nga Banka pa asnjë ndryshim në “shumat e miratuara”, me qëllim që të reflektojë:

i) Përdorimin e kursimeve nga kostoja totale e projektit që është 2 140 000 USD nga financimi i huas IDB/ISFD (më poshtë quhen “Fondet”) dhe rialokimin e fondeve për ndërtimin e rrugëve dytësore shtesë sipas komponentit të punëve civile të “Projektit për rindërtimin e rrugëve dytësore dhe lokale” në Shqipëri (sipas financimit të huas IDB/ISFD që i është dhënë më parë qeverisë nga projekti).

ii) Data e mbylljes së projektit shtyhet për një vit nga data e mëparshme para kësaj letërndryshimi.

3. Rrjedhimisht, është e nevojshme që nëpërmjet kësaj letërndryshimi “Letërndryshimi” që palët të shprehin pëlqimin e tyre me shkrim për rishikimin e planit të financimit, të japin pëlqimin e tyre për ndryshimet e cituara më sipër, duke nënshkruar njohjen dhe pranimin më poshtë dhe duke sigluar planin financiar të rishikuar, të bashkëlidhur si aneksi 1.





4. Termat me germa kapitale, të përdorur këtu, kanë të njëjtin kuptim që u jepet në Marrëveshje.

5. Kjo letërndryshimi mund të nënshkruhet në disa kopje, ku secila prej tyre, nëse nënshkruhet dhe dorëzohet, është një kopje origjinale dhe të gjitha kopjet së bashku përbëjnë të njëjtin instrument.

6. Kjo letërndryshimi është pjesë integrale e Marrëveshjes.

7. Përveç kur ndryshohen në mënyrë specifike ose parashikohet këtu ndryshe, dispozitat e tjera të Marrëveshjes që nuk cenohen nga kjo letërndryshimi, mbeten të vlefshme dhe të zbatueshme ndërmjet Palëve.

Me respekt,  
Për dhe në emër të  
Bankës Islamike për Zhvillim

Emri:  
Titulli:

#### NJOHJE DHE PRANIM

Ne, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesit tonë të autorizuar rregullisht, biem dakord me ndryshimin(et) e parashikuara në këtë letërndryshimi, me datën e rregullt më sipër, në lidhje me marrëveshjen e huas nr. ALB-0028, të nënshkruar më 19.7.1431H (1.7.2010 G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim.

Për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Emri:  
Titulli:

#### ANEKSI 1

Plani financiar i rishikuar i huas IDB/ISFD  
(milione USD)

Përshkrimi i komponentëve	Alokimi fillestar i aprovuar		Alokimi i rishikuar	
	Huaja	Qeveria	Huaja	Qeveria
i) Punë civile	8.17	1.28	9.12	2.48
ii) Konsulenti i projektimit të detajuar	1.00	-	0.88	-
iii) Konsulenti mbikëqyrës	-	1.20	-	0.20
iv) Menaxhimi i projektit	-	1.14	-	1.14

v) Trajnimi i NJQV-ve për mirëmbajtje	-	0.10	-	0.10
vi) Seminar i fillimit të projektit dhe vizitë njohëse	0.03	-	-	-
vii) Auditim financiar	-	0.08	-	0.08
<b>Nëntotali</b>	<b>9.20</b>	<b>3.80</b>	<b>10.00</b>	<b>4.00</b>
viii) Rezerva	0.80	0.20	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>10.00</b>	<b>4.00</b>	<b>10.00</b>	<b>4.00</b>

Banka Islamike për Zhvillim (shkurtimi)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (shkurtimi)

#### LIG Nr. 166/2014

### PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 3 TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS “PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRIJJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE TË QËNDRUESHME”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr. 3 i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme”.



## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8867, datë 26.12.2014 të Presidentit të Republikës Bujar Nishani**

Marrëveshje e Ndhmës së USAID-it  
Nr. 182-DOAG-13-004

**AMENDIM NUMËR TRE**

**I MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR  
OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET  
QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA  
TË AMERIKËS DHE KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË PËR FORCIMIN E SHTETIT TË  
SË DREJTËS DHE QEVERISJES SË MIRË  
DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË  
RRITJE EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË  
DHE TË QËNDRUESHME**

Datë 30 shtator 2013

Amendim numër tre i Marrëveshjes së Ndhmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë quajtur “Përfituesi i Ndhmës”).

## Neni 1

**Qëllimi i Amendimit**

Ky Amendim numër tre i Marrëveshjes së Ndhmës të USAID-it për objektiva zhvillimi i

datës 30 shtator 2013 (“Marrëveshja”) bëhet ndërmjet palëve, me qëllim që t’i japë përfituesit të ndihmës një ndihmë shtesë prej pesë milionë e pesëqind e njëzet e katër mijë dollarë amerikanë (USAID) (\$5,524,000) dhe të ndryshojë buxhetin në përputhje me sa më sipër. Kjo shumë shtesë e fondeve e bën shumën e angazhuar të Marrëveshjes deri në këtë datë, në një shumë që nuk kalon gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë (USD)(\$16,837,953).

## Neni 2

**Kontributet e palëve**

Neni 3, seksioni 3.1 (a) i Marrëveshjes fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

“Seksioni 3.1. Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të vendosur në këtë marrëveshje, USAID-i në përputhje me aktin e ndihmës së huaj të vitit 1961, të ndryshuar, i jep përfituesit të ndihmës sipas kushteve të Marrëveshjes, një shumë që nuk kalon gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë (USAID) (\$16,837,953) (Granti).

## Neni 3

**Plani financiar**

Plani financiar sipas shtojcës 1, përshkrimi të zgjeruar, seksioni III, fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

“III. Plani financiar

Plani financiar për kryerjen e objektivave dhe rezultateve paraqitet në tabelën më poshtë.

Nr.	Fusha e programit	Vitit fiskal (VF) 2013	Viti fiskal (VF) 2014	Totali VF 2013-FY 2016
1	Shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut	\$2,189,000	\$1,750,000	5,339,000
2	Qeverisja e mirë	\$4,557,662	\$3,014,000	12,345,662
3	Shoqëria civile	\$0	\$60,000	1,000,000
4	Tregtia dhe investimet	\$500,000	\$0	1,500,000
5	Sektori financiar	\$1,250,000	\$0	1,950,000
6	Konkurrueshmëria e sektorit privat	\$1,817,000	\$0	4,817,000
7	Mbështetja për programin	\$1,000,291	\$700,000	3,000,000
	<b>TOTALI</b>	<b>\$11,313,953</b>	<b>\$5,524,000</b>	<b>29,951,662</b>



Neni 4

**Rregullat dhe kushtet e tjera**

Përveç amendimeve në këtë dokument, të gjitha rregullat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes mbeten plotësisht në fuqi. Të gjitha termat me germa kapitale në këtë Amendim numër tre do të kenë kuptimet që u jepen në marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përfituesi i Ndhmës, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky Amendim numër tre i Marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Nga: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_

Emri: Marcus Johnson

Pozicioni: Përfaqësuesi i USAID/Shqipëri

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Nga: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_

Emri: Shkëlqim Cani

Pozicioni: Ministër i Financave

**LIGJ****Nr. 167/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E  
LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE  
TË MARRËVESHJES ISTISNA'A DHE  
MARRËVESHJES SË AGJENCISË  
ISTISNA'A NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE  
PËR ZHVILLIM (IDB) PËR PROJEKTIN E  
RRUGËS TIRANË-ELBASAN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet letërmarrëveshja ndryshuese e marrëveshjes Istisna'a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave

të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.12.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8868, datë 26.12.2014  
të Presidentit të Republikës Bujar Nishani**

**BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM  
JEDDAH-ARABIA SAUDITE**

Ref:ALB-33

28.1.1435H (1.12.2013G)

Ministria e Financave

Blvd.: “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

Tiranë, Republika e Shqipërisë

Tel: +355 4 222 8405

Fax: +355 4 225 8494

E-mail: sekretariazv1@minfin.gov.al

I nderuar z./znj.,

Letër amenduese e Marrëveshjes së Istisna's dhe Marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a Nr.ALB-33, e nënshkruar më 3.5.1432H (7.4.2011G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim

1. Banka Islamike për Zhvillim (më tej e referuar si “Banka”) ka zgjeruar financimin e Istisna'a për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më tej i referuar si “Këshilli i Ministrave”) në shumën 222,700,000/-USD (dyqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind mijë \$) nëpërmjet Marrëveshjes së Istisna'a dhe Marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a të lidhur më 3.5.1432H (7.4.2011G) (referuar më tej bashkërisht si “Marrëveshjet”) për të financuar punimet e ndërtimit për Projektin e rrugës Tiranë-Elbasan, të përcaktuar në shtojcën II të Marrëveshjes së Istisna's (më tej të referuar si “Projekti”) mbi termat e përcaktuar në marrëveshjet përkatëse.

2. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet shkresës nr. 5357/7, datë 29.5.2013G, ka kërkuar dhe banka ka rënë dakord për të rishikuar planin financues të bankës pa ndryshuar shumën e miraturar, me qëllim që të pasqyrojë:



i) Financimet nga burime të tjera përveç financimeve të ISBD-së, me qëllim që të jenë në përputhje me financimet e siguruara;

ii) Financimet e siguruara nga ISBD-ja, me qëllim që të jenë në përputhje me rishikimet e kontratave të projektit;

3. Për rrjedhojë, nëpërmjet kësaj letre amenduese (“Letër amenduese”), është e nevojshme të zëvendësohet plani i financimit në shtojcën II (Përshkrimi i Projektit) të Marrëveshjes së Istisna'a dhe në shtojcën II (Përshkrimi i Projektit) të Marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a me planin e rishikuar të financimit bashkëlidhur kësaj letre amenduese.

4. Termat me germa kapitale, të përdorur në këtë shkresë, kanë të njëjtin kuptim të dhënë në marrëveshjet përkatëse.

5. Kjo letër amenduese nënshkruhet në një numër të caktuar kopjesh, ku secila prej tyre, kur nënshkruhet dhe shpërndahet, duhet të jetë kopje origjinale, dhe të gjitha kopjet së bashku përbëjnë një instrument të vetëm.

6. Kjo letër amenduese është pjesë përbërëse e marrëveshjes.

7. Të gjitha termat dhe kushtet e marrëveshjeve që nuk preken nga kjo letër amenduese vazhdojnë të jenë të vlefshme dhe të detyrueshme për palët.

8. Ju lutem, shprehni mendimin tuaj për amendimin e përcaktuar në këtë shkresë duke nënshkruar njohjen si më poshtë:

Me respekt,  
Për dhe në emër të Bankës Islamike për Zhvillim (nënshkrimi)

Emri: Birama Boubacar SIDIBE  
Zëvendës-president (Operacionet)  
Titulli: Banka Islamike për Zhvillim  
Jedah, ARABIA SAUDITE

NJOHJE

Ne, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet këtij dokumenti jemi dakord me amendimin e përcaktuar në letrën amenduese, në datën e përcaktuar sipas rregullave më lart, në lidhje me Marrëveshjen e Istisna'a dhe Marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a Nr. ALB-33, të nënshkruar më 3.5.1432H (7.4.2011G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim në shumën 222,700,000/-USD (dyqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind mijë \$).

Për dhe në emër të  
Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Emri:  
Titulli:  
Data:

#### SHTOJCA I RISHIKIMI I DYTË I PLANIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTTIT

Elementet e projektit	IDB	Fondi i Abu Dabit	Qeveria e Shqipërisë	OFID (OPEC)	Totali i përgjithshëm
<b>Marrja e tokës</b>			<b>4,100,000.00</b>		<b>4,100,000.00</b>
<b>Punimet civile</b>					
Seksioni 1 (Rruga: Tiranë-Tunel-13 km)	55,953,041.94	28,000,000.00			83,953,041.94
Seksioni 2 (Tunel-2.2 km)	84,988,029.01				84,988,029.01
Seksioni 3 (Rruga: Tunel-Elbasan-11.8 km)	51,958,842.20	15,000,000.00	-	18,360,000.00	85,318,842.20
<b>Nëntotali 1</b>	<b>192,899,913.15</b>	<b>43,000,000.00</b>	-	<b>18,360,000.00</b>	<b>254,259,913.15</b>
<b>Shërbimet e konsulencës</b>					
Studimi i fizibilitetit & projektzbatimi			2,900,000.00		2,900,000.00
Seksioni 1 (Mbikëqyrja)	921,500.00	1,000,000.00			1,921,500.00
Seksioni 2 (Mbikëqyrja)	2,435,984.54				2,435,984.54
Seksioni 3 (Mbikëqyrja)	1,050,000.00	1,000,000.00			2,050,000.00
<b>Nëntotali 2</b>	<b>4,407,484.54</b>	<b>2,000,000.00</b>	<b>2,900,000.00</b>		<b>9,307,484.54</b>
Njësia e Menaxhimit të Projektit (NJMP)	700,000.00				700,000.00
Auditi financiar	300,000.00				300,000.00
<b>Nëntotali 3</b>	<b>1,000,000.00</b>				<b>1,000,000.00</b>
<b>TOTALI</b>	<b>198,307,397.69</b>	<b>45,000,000.00</b>	<b>7,000,000.00</b>	<b>18,360,000.00</b>	<b>268,667,397.69</b>
Të paparashikuara (10%)	24,392,602.31	5,000,000.00	-	2,040,000.00	31,432,602.31
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>222,700,000.00</b>	<b>50,000,000.00</b>	<b>7,000,000.00</b>	<b>20,400,000.00</b>	<b>300,100,000.00</b>
<b>Përqindja</b>	<b>74.21</b>	<b>16.66</b>	<b>2.33</b>	<b>6.80</b>	<b>100.00</b>

**VENDIM****Nr. 906, datë 17.12.2014**

**PËR SHPËRBLIMIN DHE  
KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE  
TË VEÇANTA PËR FESTAT E  
FUNDVITIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për shpërblimin, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për kategoritë:

a) Nxënës me rezultate të shkëlqyera në ciklin e dytë të sistemit 9-vjeçar dhe të mesëm, në arsimin publik;

b) Studentë të ekscelencës, në arsimin e lartë publik.

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i shtohet fondi prej 661 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një milionë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për kompensimin financiar për kategoritë e veçanta, si më poshtë vijon:

2.1 Në masën 3 000 (tre mijë) lekë, për kategoritë:

a) Familje, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Familje, që kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë, me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;

c) Individë, përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

ç) Individë, përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2.2 Në masën 2 000 (dy mijë) lekë, për kategoritë:

a) Persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) Persona që marrin pension, sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Persona që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, si dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

ç) Persona që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2.3 Në masën 3000 (tre mijë) lekë, për kategorinë e pensionistëve kryefamiljarë që, aktualisht, trajtohen me kompensim për energjinë elektrike, sipas vendimit nr. 565, datë 2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

2.4 Në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për kategorinë e veteranëve të LANÇ-it.

2.5 Në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për kategorinë e ish-të përndjekurve politikë, që, aktualisht, janë mbi moshën 65 vjeç.

3. Kategoritë e përcaktuara në pikat 2.3, 2.4 dhe 2.5, të këtij vendimi, përfitojnë vetëm njërin nga kompensimet e parashikuara në këtë vendim. Ministri i Financave përcakton mënyrën e pagesës.

4. Ministrisë së Punëve të Brendshme i shtohet fondi prej 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për shpërblimin e familjeve të policëve të rënë në detyrë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.



5. Ministrisë së Mbrojtjes i shtohet fondi prej 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për shpërblimin e familjeve të ushtarakëve që janë në detyrë në misionet ushtarake jashtë vendit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

6. Efekti financiar prej 1 800 000 000 (një miliardë e tetëqind milionë) lekësh, i këtij vendimi, të përballohet, në masën 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, nga fondi i kontingjencës, parashikuar në buxhetin e vitit 2014, dhe 1 100 000 000 (një miliardë e njëqind milionë) lekë, nga fondi i kompensimit për shtresat në nevojë, parashikuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të

Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për detajimin e fondeve, sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

### **KËRKESË**

Shtetasja Syrina Muçaj kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen e zhdukjes së babait të saj, shtetasit Skënder Meçe, i datëlindjes 25.2.1960.

KËRKUESJA  
**Syrina Muçaj**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 32 lekë